



Klinë 04.05.2026

## K o m u n a e K l i n ë s

### NJOFTIM

Në mbështetje të paragrafit 7.3, të nenit 8, të Ligjit nr.03/L-139, datë 26.03.2009, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshim dhe plotësim të bërë me Ligjin nr.03/L-205 të datës 28.10.2010, njoftohen të gjithë subjektet në listë, bashkangjitur këtij njoftimi se:

1. Për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik, për realizimin e projektit “**Zgjerimi dhe Ndërtimi i Rrugës “ Malë Bashota “** ZK Dresnik si dhe duke u bazuar ne planin zhvillimor komunal dhe duke marre parasysh interesin publik, pas plotësimit të të gjitha kushteve të përcaktuara në paragrafin 1, të nenit 4, të Ligjit nr.03/L-139, të dt. 26.03.2009, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme dhe plotësimin e bërë me Ligjin nr.03/L-205, të dt. 28.10.2010, ka miratuar Vendim 01 Nr.464-12145/2026, të dt. 04.05.2026, për inicimin e procedurave të shpronësimit për “**Zgjerimi dhe Ndërtimi i Rrugës “ Malë Bashota “** ZK Dresnik
2. Komuna do të marrë një Vendim Preliminar mbi ligjshmërinë e Shpronësimit të propozuar brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike, pas përmbushjes së kushteve të përcaktuara në nenin 9 të Ligjit nr.03/L-139, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme lidhur me organizimin e dëgjimit publik.
3. Çdo person i interesuar ka të drejtë të paraqes komentet e tij me shkrim lidhur me shpronësimin e propozuar në Organin Shpronësues brenda (10) ditëve kalendarike, pas shpalljes së Vendimit të Kryetarit të Komunës së Klinës, me **01 Nr. 464-12145/2026**, të dt. 04.05.2026 për shqyrtimin e mëtejme të kërkesës për shpronësim.
4. Komuna do të mbajë një dëgjim publik lidhur me shpronësimin e përhershëm të **Zgjerimi dhe Ndërtimi i Rrugës “ Malë Bashota “** Zona Kadasrale Dresnik.
5. Të gjithë personat të cilët janë zyrtarë publikë të komunës në të cilin mbahet dëgjimi publik, ose pronar apo zotërues të interesit në pronën e cila gjendet brenda kësaj komune, ose avokat apo përfaqësues të ligjshëm të këtyre personave, kanë të drejtë të marrin pjesë në dëgjimin publik.

6. Çdo personi të lartpërmendur do t'i jepet mundësi e arsyeshme për t'i shprehur mendimet e tij/saj gojarisht lidhur me shpronësimin e kërkuar në përputhje me paragrafët 2- 4, të nenit 9, të Ligjit nr.03/l-139, të dt. 26.03.2009, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/L-205 dt.28.10.2010.
7. Çdo person i cili dëshiron të marrë pjesë ose të shprehë mendimet e tij/saj në dëgjimin publik, duhet të sjellë me vete provat e arsyeshme (dokumente) të cilat dëshmojnë se ai/ ajo është zyrtar publik, apo pronar ose zotërues i interesit, apo avokat ose përfaqësues i ligjshëm i atij zyrtari publik ose zotërues i interesit .
8. Dëgjimi publik lidhur me shpronësimin e kërkuar të të drejtave pronësore apo të drejtave të tjera në pronat e paluajtshme, që ndodhen brenda juridiksionit territorial të komunës së Klinës, do të mbahet më datë **05.06.2026 në ora 10:00**, në sallën e Kuvendit komunës së Klinës.
9. Ne rast së prona e cila është objekt i kërkesë shpronësohet pas përmbylljes së procedurës së shpronësimit te iniciuar ne përputhje me atë kërkesë , asnjë kompensim nuk do të paguhet për shpenzimet ose vlerën e çfarëdo përmirësimi të bërë në pronë, objektet e ndërtuara apo zgjeruara në pronë, ose pemë apo bime të mbjellura në pronë pas datës së përmbushjes së dispozitave përkatës të paragrafit 8 të nenit 8 të Ligjit nr.03/l-139, të dt. 26.03.2009, për shpronësimin e pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/L-205 dt.28.10.2010.
10. Çdo person i cili pretendon së ka një interes pronësor ose interes tjetër të ligjshëm në pronën përkatëse këshillohet ta shqyrtoj ligjin e shpronësimit Ligjit nr.03/l-139, të dt. 26.03.2009, për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/L-205 dt.28.10.2010, dhe te kërkoj ndihmë profesionale juridike për kuptimin e te drejtave e tyre sipas ligjit
11. Çdo person i cili nuk është emëruar në njoftim dhe i cili pretendon së zotëron një interes pronësor ose interes tjetër të ligjshëm, në cilëndo parcelë të pronës së paluajtshme të përshkruar në njoftim, menjëherë duhet të dërgojë në organin shpronësues një përshkrim të pretendimit të tij, bazën juridike të atij pretendimi si dhe kopjen e certifikuar të çfarëdo dokumenteve që ndërlidhen me atë pretendim.